



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.601/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevc i kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Ilir Abazi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, lidhur me tërheqjen nga lista si kandidat për Anëtar të Kuvendit të Komunës në Viti nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, si kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, në seancën e panelit të mbajtur me 15.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

KONSTATOHET i tërhequr apeli Anr.601/2021 i datës 14.09.2021, i parashtruar nga Ilir Abazi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Arsyetim

Me datën 14.09.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Ilir Abazi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) në të cilën kërkon që të tërhiqet nga lista për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, pasi që sipas apeluesit pa pëlqimin e tij është futur në listë.

Ndërsa me datë 15.09.2021, apeluesi Ilir Abazi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës me nr.A.nr.601/2021 të datës 14.09.2021 me arsyetimin se emri i tij është larguar nga lista e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.601/2021 më datën 15.09.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.